Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0596

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik (OSHP), në bazë të nenit 105, 106 dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës (Ligji Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092), në përbërje nga: Vedat Poterqoi - Kryetar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga grupi i Operatorit Ekonomik (OE)"BakiAutomobile"SH.P.K.,lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Servisimi dhe mirëmbajtja e automjeteve tip VW" me nr. të prokurimit: "KOSTT-23-1693-2-2-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – "Oper. Sistemi, Trans, dhe Tregu – KOSTT SH.A." me datën 12.10.2023, mori këtë:

Vendim

1. Aprovohet, si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik"Baki Automobile " SH.P.K., e parashtruar në Organin Shqyrtues të Prokurimit me 18.08.2023 (me numër protokolli 596/23), vendimi i AK lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Servisimi dhe mirëmbajtja e automjeteve tip VW " me nr. të prokurimit: " KOSTT-23-1693-2-2-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – "Oper. Sistemi, Trans, dhe Tregu – KOSTT SH.A.", anulohet, ndërsa aktiviteti i prokurimit kthehet në ri-vlerësim.

2. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues aprovohet si e bazuar, të njëjtit i kthehet tarifa e paguar me parashtrimin e ankesës.Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës

Arsyetim

- *Faktet dhe rrethanat procedurale –*

Me 06.03.2023, "Oper. Sistemi, Trans, dhe Tregu – KOSTT SH.A." , në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar njoftimin për kontratë për aktivitetin e prokurimit me titull: "Servisimi dhe mirëmbajtja e automjeteve tip VW" me nr. të prokurimit:" KOSTT-23-1693-2-2-1"Nderkaq

me datën 04.08.2023 eshte publikuar njoftimi mbi vendimin e AK.

OE "Baki Automobile" SH.P.K me datën 19.05.2023 ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim në AK. Me datën 26.05.2023, AK-"Oper. Sistemi, Trans, dhe Tregu – KOSTT SH.A."me vendim ka refuzuar si te pa bazuar kërkesat per rishqyrtim.

I pakënaqur me vendimin e AK-së, OE ankues "BakiAutomobile" SH.P.K. me datën 18.08.2023 ka parashtruar ankesë në OSHP, me numër të protokollit 596/23, kundër vendimit të Autoritetit Kontraktues lidhur me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedure te hapur, lloji i kontratës: Sherbim, vlera e parashikuar e kontratës: 100.000.00 €.

Ankesa e OE është ushtruar në pajtim me nenin 109.1, të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK çdo palë e interesuar mund të parashtrojë ankesë pranë OSHP. Meqë OE ka ushtruar po ashtu kërkesë për rishqyrtim, do të thotë se veprimet e të njëjtit i referohen po ashtu dhe nenit 108/A të Ligjit të cituar. Prandaj OSHP konsideron se Ankesa i plotëson kushtet e parapara në kuptim të dispozitave tani më të cituara dhe e njëjta bie nën kompetencat e tij në kuptim të nenit 105, të LPP.

- Vlerësimi dhe administrimi i provave –

Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka angazhuar ekspertin vlerësues në pajtim me nenin 111, paragrafi 5 të LPP, me detyrë që i njëjti në kuptim të nenit 113 të Ligjit të cituar, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkitazi me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër. Lidhur me ketë, me 04.09.2023 eksperti shqyrtues ka dorëzuar Raportin e vlerësimit me rekomandimet si në vijim:

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e Grupit të OE "BakiAutomobile" SH.P.K.,

Refuzohet, ankesa e operatorit ekonomik"Baki Automobile " SH.P.K., e parashtruar në Organin Shqyrtues të Prokurimit me 18.08.2023 (me numër protokolli 596/23) për aktivitetin e prokurimit me titull: "Servisimi dhe mirëmbajtja e automjeteve tip VW " me nr. të prokurimit: " KOSTT-23-1693-2-2-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – "Oper. Sistemi, Trans, dhe Tregu – KOSTT SH.A."

Të mbetet ne fuqi vendimi I Autoritetit Kontraktues.

- Konstatimet e panelit shqyrtues -

Palët janë në dijeni lidhur me shkresat e kësaj lënde sikurse kërkohet në pajtim me paragrafin 2, të nenit 20 të Rregullores së cituar dhe konstatohet se nuk ekzistojnë elementet për parandalim të konfliktit të interesit, siç kërkohet në kuptim të nenit 11 të Rregullores për Punën e OSHP. Prandaj Paneli analizoi në vijim shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe veprimet e

palëve dhe pohimet e tyre konsideroi se nuk ka nevojë të konvokohet seanca publike me palë sepse ka prova të mjaftueshme dhe ka kushte të vendoset në mënyrë meritore përkitazi me ankesën në rastin konkret, sikurse parashihet me paragrafin 1, të nenit 24 të Rregullores së cituar.

Paneli shqyrtues administroi me të gjitha shkresat e kësaj lënde, duke i analizuar të gjitha pohimet ankimore, aktet dhe veprimet e palëve të cilat (në përmbledhje) i shqyrtoi dhe si përfundim paneli shqyrtues do të ndalet vetëm tek pretendimi ankimor i OE, pretendim i cili përcakton dhe rrjedhën e vendimarrjes sa i përket shqyrtimit të kësaj lënde.

Pohimet ankimore të OE ankues

Ankuesi (me të dhëna si më sipër) ka atakuar vendimin e cituar si më sipër të AK nga aspekti i pergjegjshmërisë së OE të rekomanduar për kontratë duke pretenduar se AK ka bërë shkelje të dispozitave ligjore, dhe legjislacionit dytësor, ngase kundërligjshëm ka shpall fitues një OE i cili nuk ka dërguar specifikim teknik konform kërkesë së dosjes së tenderit, ashtu sikurse kërkohet me LPP, që d.t.th. nuk ka dëshmuar se i plotëson specifikat teknike ashtu siç theksohen në Dosjen e Tenderit dhe për këtë nuk mund të kërkohen sqarime shtesë. Në ofertën e OE të rekomanduar mungom përmbushja e specifikave teknike të paraqitura në dosjen e tenderit tek pika 3.0 dhe 3.2, ku kërkohen nga AK që OE i cili pretendon të jetë fitues i i kësaj kontrate kërkohen: "3.0 Dy automjetet SKODA OCTAVIA 2.0 TDI janë në afat të garancionit deri me 14.10.2024 prandaj nga Ofertuesit Ekonomik duhet të merren udhëzimet nga garantuesi (**Porsche Kosova)** në mënyrë që të na velej garancioni;" dhe "3.2 Çdo pjesë (pozicion) i ndërruar duhet të jetë origjinal dhe për të gjitha pozicionet e lartshënuara garancioni që duhet të ofroi ofertuesi duhet të jetë së paku një vjeçar (ose kilometra sipas udhëzimeve të prodhuesve), kurse për bateri se paku garancioni duhet të ofrohet dy vjeçar".

Lidhur me këto pretendime të njëjta OE ankues i ka paraqitur paraprakisht edhe në kërkesat paraprake për ri-shqyrtim pranë AK, me çrast AK ka bërë aprovim të pjesërishëm të pretendimit ankimore: " Pajtohemi me konstatimin e juaj se i mungojnë dëshmitë sipas kërkesës së parashtruar në specifikim teknik, por nuk pajtohemi me pretendimin e juaj se mungon specifikimi teknik dhe se nuk mund të kërkohen dokumentet e lartëcekura". Kështu që AK lëndën e ka kthyer në ri-shqyrtim duke kërkuar sqarime shtesë sa i përket plotësimit të kësaj deklarate dhe OE i rekomanduar për kontratë ka sjellë një deklaratë tjetër ndryshe nga e para të dt. 24.07.2023 dhe duke i përfshirë edhe garancionet sa i përket pikës 3.0 dhe 3.2 të specifikave teknike. Lidhur me këtë eksperti shqyrtues e hedhë poshtë edhe pretendimin ankimore të OE ankues si të pa bazuar edhe përgjigjen e AK në kërkesën për ri-shqyrtim duke dalur me një konstatim të ri se OE i rekomanduar për kontratë ka plotësuar kërkesën e dosjes së tenderit duke ofruar deklaratën për specifikimin teknik me ofertën e dorëzuar më dt. 12.04.2023 dhe pothuajse komplet çdo pretendimi ankimore i ka jap përgjigje me këtë konstatim.

Për panelin shqyrtues ky konstatim i ekspertit shqyrtues nuk paraqet pasqyrim të gjendjes reale, sepse detyrë e ekspertit ka qenë së të nxirret një konstatim i saktë i dispozitvae ligjore dhe përmbushjes së kërkesave duke ju referuar shkresave të cilat i ka pasur në dispozicion përfshirë edhe përgjigjet e AK në kërkesat për ri-shqyrtim. Megjithatë, paneli shqyrtues si rezultat i hulumtimit të të gjithë dokumentacionit dhe konsistencës në vendime nuk e mbështet konstatimin e ekspertit shqyrtues. Për panelin shqyrtues ky pretendim ankimor është i bazuar, ngase ne dokumentacionin e këtij aktiviteti rezulton se ne ofertën e OE përkatësisht Deklarata

për Specifikimet teknike nuk është konform kërkesave të AK këtë e ka pranuar edhe vetë AK duke e kthyer lëndën në ri-vlerësim. Ky konstatim se kërkesa nuk është plotësuar e vërteton edhe kërkesa për sqaim nga AK dhe deklarata tjetër e ofruar nga OE i rekomanduar dhe përfshirja/plotësimi i saj edhe me pika tjera. Kjo deklaratë për panelin shqyrtues përbënë ndryshim material dhe paneli shqyrtues konstaton se vlerësimi i ofertave nuk është bërë konform dispozitave ligjore, të cilat do të ceken më poshtë:

Sipas nenit 38 "Sqarimi i Tenderëve", paragrafi 2 të Rregullat nr. 001/2022 për Prokurim Publik i cili citon: "Asnjë ndryshim në çmim ose kusht tjetër material ose aspekt të tenderit nuk mund të kërkohet, ofrohet ose lejohet.";

Sipas nenit 40 "Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve", paragrafi 4 të Rregullat nr. 001/2022 për Prokurim Publik i cili citon: "Gjatë procedurës për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve asnjë komunikim dhe negocim nuk duhet të ndodhë në mes të autoritetit kontraktues dhe tenderuesve, përveç komunikimeve që janë autorizuar saktësisht nga nenet 34 dhe 35 të LPP. Megjithatë, vetëm sqarim i tenderëve mund të ndodhë pa ndonjë ndryshim të kushteve materiale ose aspekte të tenderit, përveç atyre të lejuara me nenin 59 dhe 72 të LPP-se";

Sipas nenit 40 "Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve", paragrafi 8 të Rregullat nr. 001/2022 për Prokurim Publik i cili citon: "Për të lehtësuar ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve, autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga secili tenderues individualisht të sqaroj tenderin e tij /saj sipas nenit 38 të kësaj rregullore. Kërkesa për sqarim dhe përgjigjja duhet të bëhen me shkrim përmes platformës elektronike, por asnjë ndryshim në çmim ose në ndonjë kusht ose aspekt material të tenderit nuk mund të kërkohet, ofrohet ose lejohet.";

Në nenin 45, paragrafi 20 të Rregullat nr. 001/2022 për Prokurim Publik, sqarohen ndryshimet materiale, i cili citon: "Mundësia për pranimin e tenderëve, varet nga ajo se çfarë janë "aspektet materiale". Për sa i përket elementeve kontraktuale të dosjes së tenderit, çdo aspekt do të konsiderohet si material, nëse ka mundësi të ndryshojë kushtet e kontratës në lidhje me për shembull cilësinë ose kërkesat epërformancës, çmimin ose mënyrën e pagesës, garancinë, sigurimin ose detyrimin dhe sidomos në rastet kur ndryshimi çon në një reduktim të të drejtave kontraktuale të autoritetit kontraktues ose obligimeve të tenderuesit kontraktual. Për sa i përket specifikimeve teknike, është e vështirë në përgjithësi për të dhënë shembullin se çfarë është "materiale". Në një fund të spektrit janë devijime që në realitet janë variante në rastet kur variante të tilla nuk janë të lejuara, shih nenin 29 të LPP-se, këto do të konsiderohen të jenë materiale. Megjithatë, edhe devijimet më të vogla në shumicën e rasteve do të konsiderohen materiale, kur ato ndikojnë për shembull në qëllimin bazë ose kapacitetet funksionale të asaj që kërkohet në bazë të kontratës. Nëse një devijim është material apo edhe çdo devijim tjetër do të varet nga formulimi konkret i dosjes së tenderit. Në disa raste një zgjidhje e propozuar mund të devijojë nga ajo që autoriteti kontraktues e kishte imagjinuar dhe ende të përfshihen brenda kushteve të gjera apo të paqarta të dosjes së tenderit. Në këto raste është sigurisht formulimi i dosjes së tenderit dhe jo pritjet e autoritetit kontraktues që kanë rëndësi. Njësia matëse është nëse devijimi do ta bënte të pamundur për të krahasuar tenderët dhe për këtë arsye për të vlerësuar tenderët në mënyrë të barabartë. Siç është përmendur në 45.21 të kësaj rregullore dhe këtij autoriteti kontraktues do të jetë në gjendje të pranojë devijime të vogla në rastet kur devijimet të tilla mund të kuantifikohet.Për të lehtësuar ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve, autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga secili tenderues individualisht të sqaroj tenderin e tij

/saj sipas nenit 38 të kësaj rregullore. Kërkesa për sqarim dhe përgjigjja duhet të bëhen me shkrim përmes platformës elektronike, por asnjë ndryshim në çmim ose në ndonjë kusht ose aspekt material të tenderit nuk mund të kërkohet, ofrohet ose lejohet"

Sipas nenit 59, paragrafi 4 i LPP citon: "Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Pavarësisht nga e mëparshmja, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse: (i) përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspekin e tenderit ne fjalë, ose (ii) **përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit**; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve.";

Sipas nenit 72, paragrafi 3 i LPP citon: "Sigurimi i informacionit qe mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për **dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar,para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive**";

- Përfundim -

Paneli shqyrtues konsideron pohimi i lartëcekur ankimor është i bazuar, sikurse është shpjeguar si më sipër, kurse AK nuk ka vepruar në pajtim me dispozitat ligjore të LPP dhe legjislacionin dytësor ashtu sikurse është përshkruar më lartë. Kthimi i një aktiviteti të prokurimit në ri-vlerësim, me fakte dhe prova kontestuese dhe/ose me bazë ligjore, është në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: "...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji".

Lidhur me nenin 105, duke e pasur parasysh kërkesën e nenit 104, paragrafi 1, të Ligjit të cituar sipas të cilit, cituar: "Procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e drejtë, të ligjshme dhe efektive të lëndës..." Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Andaj nga të lartcekurat, paneli shqyrtues ne pajtim me nenin 117 të LPP-së vendosi si në dispozitv të këtij vendimi.

Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - **Oper. Sistemi,Trans.dhe Tregu- KOSTT SH.A.**
- OE - **„Baki Automobile" SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: